



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:168196

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05528336

P.nr.327/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me bashkëpunëtoren profesionale Diellza Zeqiri Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurve B.M nga Vushtrria, dhe të pandehurit F.H nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.707/21 e dt.15.10.2022, në praninë e Prokurores së shtetit Albana Parduzi, të pandehurit të parë B.M, dhe mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare Av.Miralba Nikqi, dhe të pandehurit të dytë F.H dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit Av.Kushtrim Salihu, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 27.03.2024, me datë 29.03.2024 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

TË PANDEHURIT:

1. B.M, nga i ati Sh., e ëma N., e vajzërisë S., i lindur më dt ..., në Vushtrri, ku edhe jeton, me numër personal të Lnj ... të lëshuar nga MPB-ja, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar për vepra penale me aktgjykimet P.nr.70/19, P.nr.104/2019, P.nr.30/21, P.nr.462/21, P.nr.166/22 dhe P.nr.2140/21, gjendet në vuajtje të dënimit.

2. F.H, nga i ati Sh.1, e ëma V., e vajzërisë I., i lindur më dt ..., në Vushtrri, ku edhe jeton, me numër personal të Lnj ... të lëshuar nga MPB-ja, ka të kryer shkollën e mesme, punon në dyqanin e vëllait të tij me teknikë të bardhë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar për vepra penale me aktgjykimet P.nr.291/21 dhe P.nr.303/22.

JANË FAJTORË

SEPSE: Më datë 04.03.2021 rreth orës 02:00 në Vushtrri, me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm dhe pas marrëveshjes paraprake kanë tentuar të marrin pasurinë e personit tjetër, në atë mënyrë që kanë ardhur para qebaptores “TB” kur i pandehuri i dytë F.H duke përdor

forcën me një mjet të përshtatshëm (dara) e ka thyer drynin nga dritarja e cila ishte në afërsi të skarës, ka hapur dritaren dhe në momentin kur kanë planifikuar që të hynin brenda në lokal dhe të kryenin vjedhjen, janë vërejtur nga ana e policisë dhe janë penguar në kryerjen e veprës penale të lartpërmendur,

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 28, 31, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 69, 70, 71, 72 dhe nenit 315 par.1, pika 1.1 të KPRK-së si dhe nenit 241, 364, 452 të KPPK-së.

G J Y K O N

1.TË PANDEHURIT B.M i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muaj dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëmijë (1,000) euro, e të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh.

2.TË PANDEHURIT F.H i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej katërmëdhjetë (14) muaj dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëmijë (1,000) euro, e të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh.

DETYROHEN të pandehurit secili veç e veç që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej tridhjetë euro (30€), në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale ta realizojë në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.707/21 e dt.15.10.2022, kundër të pandehurve B.M nga Vushtrria, dhe të pandehurit F.H nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin PA1.nr.1010/23 të datës 15.11.2023, ka aprovuar ankesën e mbrojtëses së të pandehurit të parë, av.Miralba Nikqi, ashtu që lëndën P.nr.327/23 e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, me rekomandimet se në rigjykim dhe rivendosje Gjykata e shkallës së parë duhet të evitohet shkeljet dhe të metat e aktgjykimit, ashtu që i njëjti duhet të përmbajë një dispozitiv që nuk do të jetë konfuz dhe në kundërshtim me veten e tij, por i cili duhet të jetë i përpiluar konform dispozitave ligjore në fuqi, ashtu që të përmbajë periudhën verifikuese të dënimeve të njëjta si me shkronja ashtu edhe me numra, e po ashtu përmirësimet e tilla duhet t'i përmbajë edhe arsyetimi i aktgjykimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar.

Deklarimi i të pandehurve lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më dt.27.03.2024, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të njëjtëve u ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që:

I pandehuri i parë B.M ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër, njëherit i kërkon ndjesë të dëmtuarit.

I pandehuri i dytë F.H ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar për kryerjen e veprës penale, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale të kësaj natyre apo natyrës tjetër, njëherit i kërkon ndjesë të dëmtuarit.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tyre, se pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë, si dhe gjykatës i propozon që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Avokatja mbrojtëse e të pandehurit të parë e caktuar sipas detyrës zyrtare av.Miralba Nikqi, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, ashtu që i propozon gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të saj.

Avokati mbrojtës i të pandehurit të dytë av.Kushtrim Salihu, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, ashtu që i propozon gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të pandehurit i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Raport fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-BD-175 të datës 04.03.2021, Raporti i oficerit i dt.04.03.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje

për dëshmitarin R.M i datës 04.03.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin B.M i dt.17.03.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin F.H i dt.04.03.2021, Foto dokumentacion në shtojcë prej 16 fotove, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt.04.03.2021, lista e dëshmive, informacione lidhur me të kaluarën kriminale të të pandehurve, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se të pandehurit me dashje në bashkëkryerje kanë tentuar të kryejnë veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 315, par.1, pika 1.1 të KPRK-së është përcaktuar se veprën penale Vjedhja e rëndë e kryen “1. Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse: 1.1. vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sëndukët apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme”, ndërsa neni 31 i KPRK-së përcakton se “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.” E po ashtu neni 28 i KPRK-së përcakton se “1. Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale. 2. Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë tjetër vepër penale dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj. 3. Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet.”

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurit t’i shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Vjedhja e rëndë në tentativë nga neni 315, par.1, pika 1.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtëve përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat janë edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethana lehtësuese gjykata për të pandehurin e parë ka vlerësuar premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, moshën e tij të re, i njëjti është i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike. Po ashtu, këto rrethana lehtësuese gjykata i gjeti edhe për të pandehurin e dytë, i cili i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, moshën e tij të re, i njëjti është i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, si dhe është i punësuar. Ndërsa si rrethanë veçanërisht

lehtësuese konform nenit 71, par.1.3 të KPRK-së, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e dy të pandehurve.

Ndërsa si rrethana rënduese gjykata lidhur me dy të pandehurit e lartcekur ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, me ç'rast vepra penale është tentuar të kryhet me dashje nga ana e të pandehurve, si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, po ashtu për të pandehurin e parë gjykata si rrethanë rënduese ka gjetur faktin se i njëjti është recidivist, i dënuar edhe më parë me aktgjykimet P.nr.70/19, P.nr.104/2019, P.nr.30/21, P.nr.462/21, P.nr.166/22 dhe P.nr.2140/21, e po ashtu është në vuajtje të dënimit, edhe i pandehuri i dytë është recidivist në kryerjen e veprave penale i dënuar edhe më parë me aktgjykimet P.nr.291/21 dhe P.nr.303/22.

Gjykata duke vlerësuar si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve gjatë shqyrtimit fillestar, ka aplikuar dispozitën e nenit 71 par.1, pika 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: 1.1. kur ligji parasheh se dënimi i kryesit mund të zbutet apo zvogëlohet, 1.2. kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, 1.3. në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”, e lidhur me nenin 72 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) viti, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muaj për të pandehurin e parë dhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej në kohëzgjatje prej katërmëdhjetë (14) muaj për të pandehurin e dytë dhe dënimi me gjobë në shumën prej njëmijë (1,000) euro, e të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të pandehurit nuk kryejnë vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurve do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil.”

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën

par 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.327/2023, datë 29.03.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën